



Funded by  
the European Union

# DOKUMENT POLITIKASH

për adresimin e pabarazive  
në arsim në Komunën e Kamenicës



DOKUMENT POLITIKASH  
**PËR ADRESIMIN E  
PABARAZIVE NË  
ARSIM NË KOMUNËN  
E KAMENICËS**

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e programit një-vjeçar *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit - IDEA 2022*, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për Partneritet (Framework Partnership Agreement) të nënshkruar ndërmjet KEC dhe Zyrës së BE-së në Kosovë në nëntor të vitit 2019. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

# Hyrje

Hulumtimet tregojnë se varfëria ndikon në zhvillimin kognitiv të fëmijëve më shumë se sa faktorë tjerë si edukimi i prindërve ose aftësitë kognitive të prindërve. Fëmijët e prekur nga varfëria dhe me Status Social-Ekonomik (SSE) të ulët, performojnë dukshëm më keq se sa moshatarët e tyre të klasës së mesme në shumë tregues të suksesit akademik siç janë: rezultatet e provimeve, suksesi, dështimet në lëndë të ndryshme, shkalla e diplomimit në shkollë të mesme, niveli i braktisjes së shkollës së mesme dhe vitet e përfunduara të shkollimit.

Projekti ARISE - Iniciativa për zvogëlimin e pabarazive në edukim është platformë e krijuar nga një grup i OSHC-ve nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia, anëtare të NEPC – Network of Education Policy Centers, që do të mbështesin shkollat, organizatat me bazë në komunitet dhe hartuesit e politikave në zhvillimin e iniciativave dhe politikave që synojnë zvogëlimin e efektit të statusit të ulët ekonomik në arritjet e nxënësve, duke zvogëluar pabarazitë në edukim.


Gjatë dhjetëvjetëshit të fundit, Kosova ka kaluar nëpër reforma të mëdha në arsim, duke filluar nga decentralizimi i sistemit arsimor deri te zhvillimi i kornizës kurrikulare të bazuar në kompetenca, zhvillimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë, zhvillimi profesional i mësimit dhe sistemi i licencimit, zgjerimi i përdorimit të TIK etj. Sido që të jetë, përkundër këtyre reformave, cilësia e arsimit mbetet e dobët. Kjo u dëshmuar edhe me rezultatet e PISA 2018, të cilat treguan se nxënësi 15 vjeçar i Kosovës shënoi ndër rezultatet më të dobëta në të gjitha disiplinat e testimit.

## Arsimi në Komunën e Kamenicës

Në Komunën e Kamenicës janë 2 Institucione parashkollore, 16 institucione të shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe 5 institucione të shkollimit të mesëm lartë. Në shkollimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë punojnë 721 punëtorë. Në Komunën e Kamenicës punojnë gjithashtu edhe 4 pedagogë, 8 psikologë, 8 mësime asistentë për fëmijët më nevojat të veçanta dhe 4 logopedë<sup>1</sup>.


**1.1 Tabela 1.**

Numri i fëmijëve në arsimin parashkollor<sup>2</sup> - Parashkollore (0<5 vjeç)



**1.2 Tabela 2.**

Nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët




<sup>1</sup> Sipas të dhënave të ofruara nga shkollat në muajin Tetor 2022, Drejtoria e Arsimit, Komuna e Kamenicës

<sup>2</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2021). <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-arsimit-20202021> dhe sipas shënimeve të fundit nga drejtoria e arsimit në Komunën e Kamenicës

**1.3 Tabela 3.**

Numri i nxënësve në arsimin të mesëm të lartë



### Adresimi i nevojave të fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik, përmes planifikimit shkollor dhe qasjes gjithëpërfshirëse

Në kuadër të projektit ARISE janë përzgjedhur 5 shkolla nga Kosova. Shkollat e përzgjedhura janë:

- Sh.f.m.u. “Nazim Gafurri”, Prishtinë
- Sh.f.m.u. “Liria”, Stroc, Vushtrri
- Sh.f.m.u. “Ibrahim Mazreku”, Malishevë
- Sh.f.m.u. “Dr. Ibrahim Rugova”, Obiliq
- Sh.f.m.u. “Anton Zako Çajupi”, Mitrovicë



Secila nga shkollat partnere kanë krijuar “Ekipin Shkollor të Veprimit” të përbërë nga përfaqësues të: Këshillit të Nxënësve, Këshillit të Prindërve, Mësimdhënësve dhe Menaxhmentit të Shkollës.

- Ekipet Shkollore të Veprimit – EShV-të nga shkollat partnere kanë hartuar Planet e Veprimit me qëllim të adresimit të nevojave të nxënësve me status të ulët socio-ekonomik, të cilat mund të integrohen në Planin Zhvillimor të Shkollës - PZhSH, apo të përfshihen në formën e një Aneksi të PZhSh që adreson në mënyrë specifike zvogëlimin e pabarazive në shkollë, përkatësisht, adresimin e nevojave të nxënësve me status të ulët socio-ekonomik.
- Nga muaji mars 2022, në konsultim dhe aprovim nga Këshilli Drejtues i Shkollës, EShV-të kanë filluar zbatimin e këtyre “Planeve të Veprimit”.
- Secila nga objektivat e Planit të Veprimit përmban: aktivitetet, personat përgjegjës, burimet, koston financiare, afatin dhe dëshmitë e aktiviteteve.
- Çdo shkollë në Planin e veprimit ka vendosur si objektiv të përgjithshëm: *Krijimi i ambientit shkollor përkrahës dhe gjithëpërfshirës që siguron mundësi të barabarta*

### Sfidat, masat dhe rekomandimet në sigurimin e mundësive të barabarta në arsim

E drejta për arsimim dhe zhvillim të potencialit të plotë të një fëmije është një prej të drejtave themelore dhe si e tillë garantohet me Kushtetutën e Kosovës. Në këtë kontekst, korniza ligjore e Kosovës parashihet dhe mbështet një qasje gjithëpërfshirëse, e cila lufton braktisjen e arsimit të obligueshëm dhe garanton qasje të barabarta në arsim pa marrë parasysh etninë, gjininë, racën, statusin ekonomik etj.

Mbështetja e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik është përfshirë në Strategjinë e Arsimit dhe Planin e Veprimit 2022 -2026. Më konkretisht, Aktiviteti 2.3.7 i *Strategjisë së Arsimit dhe Planit të Veprimit*, definon mbështetjen e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik, ndërsa përgjegjëse për zbatimin e saj është DKA-ja. Progresi në këtë fushë do të matet me këta dy indikatorë:

1. Rritet numri i fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik në arsimin e obligueshëm, që përfitojnë përmes formave të ndryshme të përkrahjes (bursave, transportit, etj.)
2. Numri i fëmijëve që përfitojnë me forma alternative të mësimin, i ndarë në baza gjinore

## Masat standarde për zvogëlimin e pabarazisë në arsim



Arsimi i obligueshëm me qasje të barabartë dhe falas;

Te vazhdohet transporti falas për fëmijët që jetojnë brenda distancës prej katër (4) km nga shkollat;



Arsimi parashkollor falas për fëmijët nga kategoritë e cenueshme (asistenca sociale, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, fëmijët pa përkujdesje prindërore);

Themelimi i Qendrave Mësimore në komunë për të mbështetur fëmijët që vijnë nga grupet e cenueshme në arsim;



Funksionalizimi dhe fuqizimi i mekanizmave për të parandaluar braktisjen e shkollës dhe mos regjistrimin në shkollë (EPRBM), dhe në promovimin e diversitetit përmes një sistemi të integruar arsimor;

Bursa për nxënësit me status të ulët socio-ekonomik nga të gjitha komunitetet e veçanta nga komuniteti rom, që janë të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë.



## Rekomandime me qëllim të zvogëlimit të barazisë në arsim për komunën e Kamenicës:

- Shkollat të përfshijnë në Planifikim adresimin e nevojave të fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik;
- Të rritet bashkëpunimi ndërmjet shkollave, DKA-së dhe Qendrës për Punë Sociale në evidentimin e rasteve të braktisjes së shkollës së fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik;
- Organizimi i orëve plotësuese dhe programeve të tjera këshilluese në nivel të shkollës, për të përmirësuar të nxënët e nxënësve dhe përfshirjen në shkollë;
- Adresimin e çështjes së varfërisë dhe studentëve të prekur nga varfëria duke ndryshuar dhe përmirësuar politikën arsimore dhe sociale që mund të ofrojnë zgjidhje afatgjata për krijimin e barazisë në arsim;
- Të intervenohet në nivelin e shkollës për të adresuar nevojat emergjente të nxënësve me Status të Ulët Socio-Ekonomik (SSE) duke siguruar ambient përkrahës dhe gjithëpërfshirës;
- Rritja e angazhimit të prindërve në shkollë; si dhe mësimdhënësit të punojnë dhe bashkëpunojnë me shumë me prindërit dhe nxënës me status të ulët socio-ekonomik;
- Përmirësimi i kushteve / klasat e shkollës sepse ato kontribuojnë më shumë në ndryshimet e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik në normat e të mësuarit sesa karakteristikat e familjes;
- Ofrimi i programeve dhe trajnimeve shtesë për zhvillimin profesional të mësimdhënësve (ZHPM) dhe drejtuesve të shkollave në bazë të nevojave;
- Zbatimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore në komunë;
- Rritje dhe ndarje të buxhetit komunal për transport të nxënësve;
- Anëtarët e këshillave të prindërve të jenë më aktiv dhe kërkues ndaj ofrimi të transportit dhe përmirësimit të kushteve në shkollë në përgjithësi;



